

20140431262

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR INSPEKSION FINANCIAR NË SEKTORIN
PUBLIK

Neni 1

Në Ligjin për inspeksion financiar në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/13), në nenin 6 në paragrafin (2) fjalët: "inspektor kryesor financiar për financa publike (në tekstin e mëtejme: inspektori kryesor)" zëvendësohen me fjalët "inspektori kryesor".

Neni 2

Në nenin 7 paragrafi (2), fjalët: "kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për nëpunës shtetërorë" zëvendësohen me fjalët: "kushtet nga Ligji për mbikëqyrje inspektuese".

Neni 3

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin, punësimin, avancimin, përsosjen profesionale dhe aftësimin, matjen e kontributit dhe çështje tjera në lidhje me marrëdhënien e punës së inspektorëve financiarë zbatohen dispozitat nga Ligji për mbikëqyrje inspektuese."

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si vijon:

"(1) Pjesa e rrogës për nivel për inspektorëve financiarë caktohet në bazë të këtyre pikëve:

- niveli B2: 983 pikë,
- niveli B3 709 pikë,
- niveli B4: 664 pikë,
- niveli V1: 497 pikë,
- niveli V2: 408 pikë,
- niveli V3: 385 pikë dhe
- niveli V4: 361 pikë.

(2) Pjesët e rrogës për arsim dhe përvojë pune të inspektorëve financiarë paguhet në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

(3) Vlera e pikëve nga paragrafi (1) i këtij neni është e barabartë me vlerën e pikës për nëpunësit administrativë."

Neni 5

Dispozitat nga neni 2 dhe dispozitat nga neni 3 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 12 do të fillojnë të zbatohen nga 1 korriku 2014.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, kurse do të fillojë të zbatohet në ditën e zbatimit të Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14)".